

Prof. As. Dr. Daniela Kalaja

Daniela Kalaja është e punësuar me kohë të plotë si personel akademik pranë Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universitetin e Tiranës që nga viti 2008. Pas diplomimit në Punë Sociale në vitin 1996, ka kryer studimet Master i Shkencës (MSc.) në Punë Sociale në vitin 2006 dhe nga viti 2013 mban gradën Doktore e Shkencave. Në korrik 2016 ka mbrojtur titullin Prof.As.Dr.

Fushat e saj të interesit dhe kërkimit shkencor janë në çështje të përkatësisë gjinore dhe zhvillimit, mbrojtja e fëmijëve, grupet vulnerabël/në vështirësi, etj. Eksperiencat e punës përfshijnë mësimdhënie në nivel Bachelor dhe Master dhe punë kërkimore shkencore të fokusuar në fushat e mësipërme. Aktualisht ajo mbulon në programet Master të departamentit lëndët, “Përkatësia Gjinore dhe Puna Sociale, Institucionet dhe Zhvillimi Social” dhe “Paradigmat e Studimit të Sjelljes Njerëzore dhe Mjedisi Social”, ndërsa në nivelin Bachelor, lëndët “Përkatësia Gjinore dhe Puna Sociale” dhe “Familja, Gjinia dhe Politikat Sociale”. Ajo është gjithashtu koordinatore për programin e masterit shkencor “Diversiteti, Mundësitë e Barabarta dhe Përfshirja Sociale”, pranë Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale. Kurrikulumi i saj përfshin konsulenca për institucione dhe organizata lokale dhe ndërkombëtare për kryerjen e kërkimeve, studimeve, përgatitjen e manualeve, protokolleve, standardeve dhe udhëzuesve të shërbimeve sociale, ofrimin e trajnimeve, vlerësim shërbimesh, programesh dhe politikash sociale, etj. Ajo është autore dhe bashkautore e disa (18) artikujve shkencorë të botuar brenda dhe jashtë vendit dhe pjesëmarrëse në disa (16) konferenca shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare.